



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.A.nr. 236/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Kujtim Pasuli dhe Hidajete Gashi Alaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ilir Keka, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Klinës, nga radhët e Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 17.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

Hedhet e palejuar ankesa ZL.A.nr.236/2025, e datës 16.10.2025, e parashtruar nga Ilir Keka, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Klinës, nga radhët e Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 16.10.2025, ka pranuar ankesën ZL.A.nr. 236/2025, nga Ilir Keka, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Klinës, nga radhët e Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale.

Në ankesë pretendohet se Ilir Keka, kandidat për Asamblenë Komunale në Komunën e Klinës me numër 13 në listën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), shkak të parregullsive të evidentuara gjatë procesit të votimit në Qendrën e votimit 0803 — SI-I.F.M.U. "Emin Duraku" Sferrkë, votuesja Aurita Gashi me të drejtë vote nuk figuron që e ka dhënë votën për të njëjtin, ndonëse ka votuar.

Ndërsa në Qendrën e votimit 0810/1-2 - SH.F.M.U. "Dëshmorët" – Volljakë, disa familjarë dhe dëshmitarë të tij kanë votuar për kandidatin në fjalë, por votat e tyre nuk janë evidentuar.

Kërkon që të hapet kutia 0803/01 dhe të bëhet rinumërimi i votave si dhe kutitë 0810/01 dhe 0810/02 dhe të bëhet rinumërimi i votave.

aspektin kohor, faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105.1 të Ligji Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Bazuar në arsyet e dhëna më lart, dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, i cili përcakton se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”*, dhe Nenit 13.3 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se *“PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim”*, si paragrafi 6 i kësaj Rregullore, përcaktohet se: *“në rastin kur pala ankuuese paraqet ankesë për rezultatet preliminare të tabuluara nga KQZ, PZAP-i, me vendim e hedh si të palejuar ankesën”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi për hedhjen e ankesës si të palejueshme nuk e paragjykon rezultatit përfundimtar, e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore pala mund ta atakoj rezultatit përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, dhe 13.3 Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.A nr. 236/2025 datë 17.10.2025

Kryesues i Panelit
Ramush Bardiqi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.